



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 01.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.03.2025 me titull Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Kryshec Nr. të Prok: 635-25-2237-5-2-1 dhe nr i brendeshen 635-25-012-521 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik "One-Grup" SH.P.K.. të datë 31.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Kryshec Nr. të Prok: 635-25-2237-5-2-1 dhe nr i brendeshen 635-25-012-521 nxjerr:

kundër B05 Njoftim për Kontrat , të datës 21.03.2025 të publikuar në platformën elektronike të E- Prokurimit .

Vërtetohet vendimi i A.K mbi B05 Njoftim për Kontrat të publikuar me datë: 21.03.2025

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "One-Grup" SH.P.K. me datën 29.03.2025 , ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Kryshec me Nr. të Prok: 635-25-2237-5-2-1 nr i 635-25-012-521 nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën 01.04.2025 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizes se kërkeses se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 29.03.2025 , e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka arritur në përfundim se kërkesa është e pa bazuar.,

Në kërkesës tuaj për rishqyrtim të paraqitur më datë 29.03.2025, Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar përmbajtjen e saj dhe, në përputhje me dispozitat e Rregullores për Prokurimin Publik (RrPPP), ka konstatuar se ajo është jashtë afateve ligjore të përcaktuara për paraqitjen e një kërkesë të tillë.

Në bazë të nenit 60.1 të RrPPP-së, përcaktohet qartë se:

"Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit, ajo duhet të paraqitet së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulimin e afateve kohore, dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)."

Duke marrë parasysh se afati për dorëzimin e ofertave është 01.04.2025, ora 14:00, llogaritja e afatit ligjor për paraqitjen e një kërkesë të vlefshme për rishqyrtim është si më poshtë:

- 29.03.2025 - Dita 0
- 30.03.2025 - Dita 1
- 31.03.2025 - Dita 2
- 01.04.2025 - Dita 3

Si rrjedhojë, kërkesa juaj është dorëzuar vetëm tre (3) ditë para afatit për dorëzim të ofertave, gjë që bie në kundërshtim me nenin 60.1 të RrPPP-së, i cili kërkon që një kërkesë për rishqyrtim të dorëzohet së paku pesë (5) ditë më herët.

Për më tepër, bazuar në nenin 63.1.1 të RrPPP-së, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur ajo nuk përmbush kriteret kohore të përcaktuara me ligj.

Konkretisht, ky nen parasheh që:

"Në rastet kur refuzimi i kërkesës për rishqyrtim ndërlidhet me njoftimet për kontratë apo dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues vazhdon më tej me aktivitetin e prokurimit, duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat e aktivitetit të prokurimit."

Për rrjedhojë, duke u mbështetur në nenet 60, 62 dhe 63 të RrPPP-së, Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës suaj për rishqyrtim si të jashtë afateshme, duke vijuar në përputhje me dispozitat ligjore për zhvillimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane me lartë ka vendosur si në dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet të dorëzohet brenda afatit ligjor .

Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.

Me respekt
MILOT GASHI
Menaxher i Prokurimit

